



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 2789/25 prot.

Tiranë, më 07.12.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 2789/17, DATË 24.11.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E HETIMIT DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATIT Z. KEN DHIMA, ME DETYRË GJYQATAR NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË LUSHNJE DHE MBYLLJEN E HETIMIT DISIPLINOR NDAJ ISH-MAGJISTRATIT Z. R. H., ME DETYRË GJYQATAR NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR FIER, NË KOHËN KUR KA NDODHUR SHKELJA E PRETENDUAR”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim praktikën e ardhur nga ish-KLD, të regjistruar me nr. 2245 prot., datë 04.05.2021, ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit z. Ken Dhima, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe me vendimin nr. 2789/17, datë 24.11.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit z. Ken Dhima, me detyrë Gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe mbylljen e hetimit disiplinor ndaj ish-magjistratit z. R. H., me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar”, bazuar në nenet 133, 134 dhe 138 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 194 dhe 214, pika 7, shkronja a) të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur përfundimin e hetimit disiplinor ndaj tij.

Vendimi duhet t’i njoftohet subjektit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, subjekti mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga subjekti, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 9, sipas adresës së lënë nga subjekti z. Ken Dhima: Rruga: “Don Bosko”, Pallatet tek “Vizion Plus”, Kulla nr. 3, Ap. 7/5, nr. 23;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

